



# KODI I ETIKËS PËR AVOKATIN E POPULLIT TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

## Hyrje

Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës,

Duke rikujtuar se Avokati i Popullit është person me karakter të lartë moral sikurse përcaktohet në nenin 34, paragrafi 9, të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar;

Duke rikujtuar parimin e pavarësisë përcaktuar në rregullën 28, pika 1 dhe 2, të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Rregullorja');

Duke rikujtuar detyrimin e konfidencialitetit përcaktuar në rregullën 29, pika 6, të Rregullores;

Duke qenë i ndërgjegjshëm se pavarësia, paanësia, konfidencialiteti dhe profesionalizmi janë themelore për kryerjen e detyrave të Avokatit të Popullit;

Duke qenë i ndërgjegjshëm për rolin jetik të Avokatit të Popullit në mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive themelore, mishëruar në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës, të personave që kanë kontakt me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës;

Duke marrë shënim betimin solemn paraparë në rregullën 28, pika 4, të Rregullores;

Me synim qartësimin e parimeve të përgjithshme që dalin nga rregullat përkatëse prej të cilave Avokati i Popullit udhëhiqet në kryerjen e detyrave të veta;

Me synim avancimin e standardeve më të larta të etikës;

Miraton këtë Kod të Etikës për Avokatin e Popullit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

## 1. Pavarësia dhe paanësia

- 1.1. Në kryerjen e detyrave, Avokati i Popullit është i pavarur, neutral, i paanshëm dhe i paangazhuar dhe nuk kërkon e as merr udhëzime nga asnjë institucion, organ, subjekt apo person, publik ose privat, jashtë Zyrës së Avokatit të Popullit. Në përputhje me rregullat e zbatueshme, Avokati i Popullit ushtron gjykimin e vet se si të veprojë në lidhje me një çështje konkrete.
- 1.2. Në trajtimin e personave dhe shqyrtimin e çështjeve, Avokati i Popullit bën çmos të jetë i paanshëm, i drejtë dhe objektiv. Ai merr parasysh shqetësimet dhe interesat legjitime të të gjithë personave që kanë të bëjnë me çështjen që shqyrtohet dhe përpiqet të gjejë të vërtetën.



- 1.3. Avokati i Popullit nuk merr pjesë në veprimtari, e as nuk merr përsipër detyrime që mund të shkaktojnë konflikt real, të perceptuar apo të mundshëm interesash, ose të komprometojnë në ndonjë mënyrë tjetër pavarësinë, neutralitetin apo paanësinë e tij.

## **2. Ndershmëria**

- 2.1. Avokati i Popullit sillet me korrektesë dhe ndershmëri, në pajtim me kriterin e moralit të lartë për postin e Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit nuk kryen sjellje dhe veprime që mund të ndikojnë negativisht në autoritetin ose emrin e Zyrës së Avokatit të Popullit.
- 2.2. Avokati i Popullit trajton çdo person me dinjitet dhe respekt dhe vepron në përputhje me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Avokati i Popullit nuk kryen keqtrajtim, ndër të tjera edhe keqtrajtim seksual, dhe shpërdorim të pozitës zyrtare në asnjë lloj forme.

## **3. Zelli**

- 3.1. Gjatë gjithë kohës, Avokati i Popullit e kryen veprimtarinë e vet me synim efektivitetin e Zyrës së Avokatit të Popullit.
- 3.2. Avokati i Popullit ndërmerr të gjitha hapat e arsyeshëm për ruajtjen dhe zgjerimin e dijeve, aftësive dhe cilësive personale të nevojshme për kryerjen e detyrave.

## **4. Dhuratat dhe përfitimet**

- 4.1. Avokati i Popullit nuk kërkon, nxjerr, pranon, ofron ose jep, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, dhurata, mikpritje, shpërblime apo çfarëdo përfitime të tjera për vete ose për ndonjë tjetër që logjikisht mund të konsiderohen se synojnë të ndikojnë në kryerjen e detyrave të tij si Avokat i Popullit.
- 4.2. Në kryerjen e detyrave, Avokati i Popullit nuk pranon, ofron apo jep ndonjë dhuratë tjetër përveç dhuratave protokollare të natyrës simbolike që ofrohen në shenjë mirësjelljeje.

## **5. Dekoratat ose nderimet**

- 5.1. Dekoratat, çmimet ose nderimet që i jepen Avokatit të Popullit duhet të jenë në përputhje me statusin e tij dhe të mos komprometojnë pavarësinë e tij apo të shkaktojnë konflikt real, të perceptuar apo të mundshëm interesash. Të gjitha dekoratat, çmimet apo nderimet bëhen publike.

## **6. Konfidencialiteti dhe transparenca**

- 6.1. Avokati i Popullit nuk nxjerr asnjë informacion konfidencial që mëson gjatë kryerjes së detyrave zyrtare apo në lidhje me kryerjen e detyrave zyrtare. Gjithsesi, Avokati i Popullit informon autoritetin apo personin kompetent për fakte që vënë në dukje ekzistencën e një rreziku real për jetën ose shëndetin e një personi nga vepra penale në rastet kur Avokati i Popullit merr një informacion të tillë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.



- 6.2. Avokati i Popullit ndërmerr hapat e nevojshëm për ruajtjen e sigurisë së informacionit konfidencial. Avokati i Popullit është veçanërisht vigjilent në lidhje me persona të cenuseshëm, siç janë viktimat e dhunës seksuale dhe gjinore dhe fëmijët.
- 6.3. Avokati i Popullit kryen detyrat në mënyrë transparente. Për aq sa është më së shumti e mundshme dhe në përputhje me detyrimin e Avokatit të Popullit për ruajtjen e konfidencialitetit, takimet profesionale dhe ngjarjet publike në të cilat merr pjesë Avokati i Popullit bëhen publike. E njëjta vlen edhe për fjalimet publike të Avokatit të Popullit ku teksti i fjalimeve është i disponueshëm.

## **7. Pas përfundimit të mandatit**

- 7.1. Pas përfundimit të mandatit, Avokati i mëparshëm i Popullit vazhdon të ketë detyrimin e ndershmërisë, maturisë dhe konfidencialitetit.
- 7.2. Avokati i mëparshëm i Popullit nuk duhet të sillet në mënyrë që i mundëson përfitime që nuk i takojnë në saje të postit të mëparshëm.
- 7.3. Avokati i mëparshëm i Popullit nuk nxjerr informacion konfidencial që ka mësuar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare apo që është në lidhje me detyrat zyrtare dhe nuk i lejohet t'i japë këshilla askujt në bazë të informacionit që nuk është i disponueshëm për publikun të cilin e ka mësuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare apo që është në lidhje me detyrën zyrtare.
- 7.4. Avokati i mëparshëm i Popullit nuk mund të përfaqësojë ose të veprojë në emër të askujt në procedura apo në lidhje me çfarëdo çështje tjetër, në qoftë se me atë çështje është marrë gjatë kryerjes së detyrave të tij të mëparshme si Avokat i Popullit.

## **8. Dispozitë përmbyllëse**

- 8.1. Ky Kod hyn në fuqi me nënshkrimin e tij prej Avokatit të Popullit dhe në datën e nxjerrjes në faqen e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Internet.

Hagë, Holandë

12 shtator 2018

---

Pietro Spera

Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës